REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.12, datë 21/03/2005

"PËR MIRATIMIN E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2004 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2005"

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, pika 1-8, dhe neni 32, gërma "ç" dhe "dh", ndryshuar me Ligjin Nr.9208, dt.18/03/2004, Ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal, ndryshuar me Ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Ligjit Nr.8379, dt.29/07/1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin Nr.8871, dt.29/03/2002, Ligjit Nr.9339, dt.21/12/2004 "Për buxhetin e shtetit për vitin 2005", Ligjit Nr.7971, dt.26/07/1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me Ligjin Nr.8767, dt.05/04/2001, neni 8, pika 5, Udhëzimit Nr.8, dt.27/01/2005 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2005", Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.1, dt.26/01/2005 "Për zbatimin e buxhetit të investimeve në arsimin parauniversitar për vitin 2005", pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë realizimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004, sipas pasqyrave Nr.1, Nr.2 dhe Nr.3 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005, sipas pasqyrave Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.3/1, Nr.3/2, Nr.3/3, dhe Nr.4, Nr.4/1, Nr.4/2, Nr.4/3 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005, në shumën prej 6.253.200.000 lekë, detajuar si më poshtë:

- Fondi i mbartur nga viti 2004	1.680.264.000 lekë
- Të ardhura tatimore	3.883.946.000 lekë
- Të ardhura jotatimore	688.990.000 lekë

4. Të miratojë përdorimin e të ardhurave për vitin 2005, sipas pikës 3 të këtij Vendimi, si më poshtë:

Fond limit për shpenzime korrente	2.333.382.000 lekë
Fond limit për shpenzime kapitale (investime)	3.919.818.000 lekë

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për të kryer transferimet gjatë vitit buxhetor për shpenzimet e funksioneve të deleguara, pas miratimit nga Ministria e Financave.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Prokurimit Publik, Njësitë Bashkiake dhe të gjithë strukturat e tjera të Bashkisë, Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.

7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI